Në bazë të nenit 21 paragrafi 1 pika 2 të Statutit të Komunës së Jegunovcit („Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit'' nr. 21/2003, 16/2010, 19/2010, 20/2014, 26/2015, 27/2019 dhe 36/2024), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e dhjetë të mbajtur më 27.02.2026, miratoi

R R E G U L L O R E
PËR KËSHILLIN E KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore për së afërmi rregullohen çështjet e caktuara lidhur me organizimin dhe mënyrën e punës së Këshillit të Komunës së Jegunovcit (në tekstin e mëtutjeshëm: Këshill), konstituimi, gjegjësisht verifikimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit, të drejtat dhe obligimet e Kryetarit të Këshillit, puna e Këshillit, komisionet e tyre dhe trupat e veçanta punuese të Këshillit, programimi i punës së Këshillit, opinioni në punën e Këshillit dhe komisionet e tyre, aktet e Këshillit, miratimi i dispozitave nga kompetenca e Këshillit, diskutimi i raporteve, analizave dhe materialeve tjera, dhënia e pëlqimit të Statuteve dhe llogarive vjetore, marrëdhënia e Këshillit me Kryetarin e komunës, marrëdhënia e Këshillit me shërbimet publike, institucioneve dhe ndërmarrjeve, marrëdhënia e Këshillit me këshillat e komunave tjera, ushtrimi i punëve profesionale për nevojat e Këshillit, ndryshimet e Rregullores, si dhe çështje tjera me rëndësi për punën e Këshillit.

Neni 2

Puna e Këshillit, e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme është publike, përveç në raste të caktuara me Ligj, Statutin e Komunës së Jegunovcit (në tekstin e mëtutjeshëm: Statuti) dhe me këtë Rregullore.

II. KONSTITUIMI I KËSHILLIT, RESPEKTIVISHT VERIFIKIMI I MANDATIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT

Neni 3

Konstituimi i Këshillit bëhet në mbledhjen e parë konstituive të Këshillit.

Këshilli është i konstituuar nëse në mbledhjen konstituive merr pjesë dhe i verifikohet mandati i shumicës nga numri i përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, me propozimin e Komisionit për verifikim.

Neni 4

Komisionin verifikues e zgjedh Këshilli nga radhët e anëtarëve të cilëve në bazë të rezultateve të arritura zgjedhore, Komisioni komunal zgjedhor u jep aktvendime për zgjedhjen e kryer në zgjedhjet e fundit lokale.

Neni 5

Komisioni verifikues, mund të kontestojë aktvendime të lëshuara nga Komisioni komunal zgjedhor, për zgjedhjen e anëtarëve të veçanta të Këshillit dhe të propozojë që verifikimi i mandatit të anulohet për shkak të përcaktimit vallë a janë dhënë ato në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve të arritura të pjesëmarrësve.

Komisioni për verifikim, çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime mund të propozojë anulim të verifikimit të mandatit të disa anëtarëve të Këshillit, për arsye se:

- me siguri nuk mund të vërtetohet identiteti i tij (emër dhe mbiemër i njëjtë me persona tjerë);
- ekzistojnë indikacione për lidhshmërinë e mundshme të funksionit (është i punësuar në administratën komunale ose ka marrë funksion ose detyrë i cili me ligj është përcaktuar si i palidhshëm me funksionin anëtar i këshillit);
- ka hyrë në fuqi pamundësia faktike për verifikimin e mandatit nën kushte të përcaktuara me ligj (në rast vdekjeje, ndërprerjes të së drejtës së banimit në komunë, aktgjykimit fuqiplotë për vepër penale ose aktvendimit të miratuar për marrjen e aftësisë afariste).

Neni 6

Komisioni për verifikim i parashtron Raport Këshillit me propozim se për cilët anëtarë të Këshillit duhet t'u verifikohen mandatet, dhe cilëve t'ju shtyhet verifikimi i mandateve.

Këshilli me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit vendos në veçanti për secilin propozim të Komisionit për verifikim, për shtyrjen e verifikimit të mandatit të anëtarëve të pranishëm të Këshillit.

Këshilli me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, vendos për çdo propozim të Komisionit për verifikim, për anulimin e verifikimit të mandatit të anëtarit të Këshillit.

Nëse propozimi për shtyrjen e verifikimit të mandatit nuk e fiton shumicën e nevojshme konsiderohet se Këshilli e ka verifikuar mandatin e anëtarit të Këshillit, për të cilin është kërkuar anulimi i verifikimit të anëtarit.

Anulimi i verifikimit të mandateve të caktuara në propozim të Komisionit për verifikim, nuk mund të jetë më gjatë se 2 muaj.

Anëtarit të Këshillit mandati i të cilit është kontestues ose verifikimi i mandatit të të cilit është anuluar, ka të drejtë të merr pjesë në mbledhjen e Këshillit dhe të merr pjesë në punën e tij, por pa të drejtë vendosjeje.

Neni 7

Verifikimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit të cilët nuk kanë qenë prezent në mbledhjen e parë të Këshillit, të atyre që janë zgjedhur në zgjedhjet për zëvendësim, si dhe të atyre, verifikimi i të cilëve është anuluar, e kryen Këshilli në mbledhjen e parë në të cilën do të marrin pjesë ata.

III. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE TË KËSHILLIT

1. Dispozita të përbashkëta

Neni 8

Anëtari i Këshillit i realizon të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me Ligj, me këtë Statut dhe me këtë Rregullore.

Anëtari i Këshillit i merr të drejtat dhe obligimet e tij pas verifikimit të mandatit.

Neni 9

Për shkak të kryerjes së detyrës së tij, anëtari i Këshillit ka të drejtë nga Kryetari i komunës, administrata komunale, shërbimet publike, nga institucionet dhe ndërmarrjet e themeluara nga Komuna dhe nga institucionet e tjera të kërkojë të dhëna të cilat i nevojiten për punën e tij në Këshill.

Neni 10

Anëtari i Këshillit, i cili nga ana e Këshillit është zgjedhur për anëtarë në organet në shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet, të themeluara nga Komuna nuk mund të merr pjesë në vendosjen e mbledhjes së Këshillit për çështje që kanë të bëjnë me shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet ku është i punësuar.

2. Pjesëmarrje në Mbledhja dhe pjesëmarrje në punën e këshillit

Neni 11

Anëtari i Këshillit ka të drejtë dhe obligim të jetë prezent në mbledhjet e Këshillit, në komisionet e përhershme dhe të përkohshme në të cilat është anëtar si dhe të merr pjesë në punën dhe vendosjen.

Neni 12

Anëtari i Këshillit ka të drejtë të merr pjesë edhe në mbledhjet e komisioneve ku nuk është anëtar, si dhe ka të drejtë të merr pjesë në punën e tyre, por pa të drejtë vendosjeje.

Neni 13

Për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit dhe në komisionet ku anëtar janë anëtarët e Këshillit, mbahet evidencë.

Evidencën e mban administrata komunale.

Neni 14

Administrata komunale e njofton Kryetarin e Këshillit për rastet kur anëtari i Këshillit tri herë radhazi mungon në mbledhjet e Këshillit dhe në komisionet ku është anëtar, kurse nuk e ka arsyetuar mungesën e tij.

Kryetari i Këshillit është i obliguar menjëherë ta njoftojë Komisionin për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime, me qëllim që të përcaktohen shkaqet e mosprezencës dhe të përcaktohet vallë a ekzistojnë kushte për përcaktimin e ndërprerjes së mandatit të anëtarit të Këshillit ose për shkarkimin e anëtarit të Këshillit nga komisionet ku është anëtar dhe t'i propozojë Këshillit që në vendin e tij të zgjidhet anëtar tjetër.

3. Ngritja e iniciativave dhe paraqitja e propozimeve

Neni 15

Anëtari i Këshillit ka të drejtë që në mbledhjet e Këshillit:

- t'i paraqesë propozimet dhe mendimet e qytetarëve dhe t'i propozojë Këshillit marrjen e qëndrimeve nga kompetenca e Këshillit për ato propozime dhe mendime;
- të jep iniciativa për miratimin e dispozitave nga kompetenca e Këshillit, si dhe të parashtrojë amandamente për propozimet e dispozitave;
- të parashtrojë kërkesë për dhënien e interpretimit autentik të dispozitave
- të inicojë shpalljen e referendumit për zgjidhjen e çështjeve me interes për Komunën, si dhe për sqarimin paraprak të qytetarëve për disa propozime të vendimeve ose për konfirmimin e tyre;
- të propozojë diskutim në lidhje me çështjet, dukuritë dhe gjendjet që janë me rëndësi për veprimtari të caktuar, si dhe me rëndësi për qytetarët;
- të propozojë diskutim për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e politës që e ka përcaktuar dhe dispozitat që i ka miratuar Këshilli ose për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve, dispozitave tjera dhe akteve tjera të përgjithshme;
- të propozojë diskutimin e çështjeve që kanë të bëjnë me punën e Kryetarit të komunës;
- të kërkojë nga Kryetari i komunës ta njoftojë Këshillin për punën e tij;
- të propozojë diskutim për çështje që kanë të bëjnë me realizimin e mbikëqyrjes së ushtrimit të punëve nga kompetenca e komunës;
- të propozojë diskutim për çështje lidhur me gjendjen në veprimtaritë për të cilat Komuna ka themeluar shërbime publike, institucione dhe ndërmarrje, si dhe çështje në lidhje me realizimin e mbikëqyrjes mbi punën e tyre dhe
- të propozojë zbatimin e anketave në lidhje me çështjet nga kompetenca e Këshillit.

Neni 16

Anëtari i Këshillit ka të drejtë vetë ose së bashku me anëtarët e tjerë të Këshillit, të propozojë zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit të Këshillit, kryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve dhe të trupave të posaçme të Komunës, të cilët i zgjedh gjegjësisht i emëron Këshilli, në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me ligj, Statutin dhe këtë Rregullore.

4. Parashtrimi i pyetjeve të këshilltarëve

Neni 17

Anëtari i Këshillit ka të drejtë Kryetarit të komunës dhe organeve udhëheqëse, respektivisht anëtarëve të organeve udhëheqëse të shërbimeve publike, institucioneve dhe ndërmarrjeve që i themelon Komuna, t'u parashtrojë pyetje (pyetje këshilltarësh) që kanë të bëjnë me punën e tyre ose me punën nga kompetenca e tyre, respektivisht nga kompetenca e organeve, shërbimeve, institucioneve dhe ndërmarrjeve.

Pyetja duhet të jetë e shkurtër dhe precize, me ç'rast anëtari i këshillit duhet të shënojë kujt i drejtohet pyetja.

Neni 18

Pyetja mund të parashtrohet gojarisht në mbledhjen e Këshillit, kurse në kohën midis dy mbledhjeve mund të paraqitet me shkrim.

Pyetjet sipas rregullës, parashtrohen dhe përgjigjja jepet para përcaktimit të rendit të ditës në mbledhjen e Këshillit.

Këshilli mund të vendos, që pyetjet të parashtrohen dhe përgjigjet të merren në fund të mbledhjes, respektivisht pas përfundimit të rendit të ditës.

Këshilli mund të mbaj edhe Mbledhja të posaçme për parashtrimin e pyetjeve, nëse propozim të tillë miraton Kryetari i komunës, Kryetari i Këshillit ose një grup prej 5 anëtarëve të Këshillit, me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen në të cilën është parashtruar.

Neni 19

Pyetjes së parashtruar gojarisht i jepet përgjigje në mbledhjen në të cilën është parashtruar, nëse është i pranishëm personi të cilit i është parashtruar pyetja ose përfaqësuesi i institucionit me të cilën ka të bëjë ajo.

Nëse pyetjes së parashtruar nuk mund t'i jepet përgjigje e plotë në atë mbledhje ose nëse nuk është i pranishëm personi të cilit i parashtrohet pyetja ose përfaqësuesi i institucionit me të cilën ka të bëjë ajo, përgjigjja e plotë do të jepet me shkrim ose gojarisht në mbledhjen e radhës së Këshillit.

Neni 20

Anëtari i Këshillit mund të kërkojë që për pyetjen e parashtruar t'i jepet përgjigje me shkrim.

Përgjigjja me shkrim jepet në afat prej 10 ditëve nga dita e parashtrimit, gjegjësisht nga dita e marrjes së pyetjes.

Nëse pyetjes nuk mund t'i jepet përgjigje në afatin nga paragrafi 2 të këtij neni, anëtari i Këshillit do të njoftohet kur do t'i jepet përgjigjja.

Nëse bëhet fjalë për pyetje të ndërlikuar, e cila kërkon analiza gjithëpërfshirëse ose kërkon përcjelljen e gjendjeve në një periudhë më të gjatë kohore, Këshilli mund të caktojë afat më të gjatë për dhënien e përgjigjes.

Neni 21

Pyetjes drejtuar Kryetarit të komunës, i përgjigjet Kryetari i komunës ose personi të cilin ai e ka autorizuar.

Kur përgjigjen e jep personi i autorizuar nga ana e Kryetarit të komunës, konsiderohet se përgjigjen e ka dhënë Kryetari i komunës.

Neni 22

Pas përgjigjes së pranuar, anëtari i Këshillit i cili e ka parashtruar pyetjen mund të parashtrojë pyetje plotësuese.

Neni 23

Pas marrjes së përgjigjes për pyetjen e parashtruar, gjegjësisht pyetjen plotësuese, anëtari i Këshillit mund të propozojë që lënda me të cilën ka të bëjë pyetja e ti,j të vihet në rendin e ditës në atë seancë të Këshillit ose në njërën nga mbledhjet e radhës.

Për propozimin nga paragrafi 1 të këtij neni, pas dëgjimit të mendimit të Kryetarit të komunës ose personit të cilit i është parashtruar pyetja vendos Këshilli.

Kryetari i komunës ose personi të cilit i është parashtruar pyetja, mund të kërkojë që diskutimi për atë çështje të anulohet derisa të grumbullohen të dhëna.

Nëse kërkesa nga paragrafi 3 të këtij neni miratohet, Këshilli cakton afat deri kur shtyhet diskutimi për atë çështje.

Neni 24

Nëse anëtari i Këshillit nuk është i kënaqur nga përgjigjja e marrë në lidhje me pyetjen e parashtruar, mund t'i propozojë Këshillit ose Kryetarit të komunës, t'i shkarkojnë personat përgjegjës dhe bartësit e funksioneve, të cilët i konsideron përgjegjës për gjendjen nga e cila nuk është i kënaqur.

Për propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni, vendosin organet e komunës së në suaza të kompetencave të veta.

5. Ruajtja e fshehtësisë

Neni 25

Anëtari i Këshillit është i obliguar të ruaj fshehtësi.

Si fshehtësi konsiderohen të dhënat që anëtari i Këshillit do t'i kuptojë në mbledhjen e Këshillit ose komisioneve, lidhur me çështjet për të cilat diskutohet në seancë pa prezencën e opinionit.

Për fshehtësi konsiderohen të gjitha materialet që i dërgohen Këshillit dhe komisioneve, dhe të cilat janë shënuar si të tilla.

Me materialet që konsiderohen për të fshehta veprohet në pajtim me vërejtjen-rekomandimin për administrimin dhe ruajtjen e materialeve, gjë që përcillen ndaj materialeve të tilla.

6. Sigurimi i kushteve për ushtrimin e funksionit anëtar i Këshillit

Neni 26

Për shkak të sigurimit të kushteve për ushtrimin e funksionit anëtar i Këshillit, administrata komunale dhe organet e udhëheqjes së shërbimeve publike, institucioneve dhe ndërmarrjeve themeluar nga Komuna, anëtarëve të Këshillit:

- u ofrojnë ndihmë profesionale në përpunimin e propozimeve të cilat ato ia parashtrojnë Këshillit, gjegjësisht komisioneve, në parashtrimin e pyetjeve të këshilltarëve dhe në ushtrimin e punëve të tjera të cilat ua ka besuar Këshilli, gjegjësisht trupi punues;
- u sigurojnë dokumentacion plotësues i cili u nevojitet punës së tyre;
- u japin shpjegime apo sqarime profesionale për problemet në të cilat ato punojnë;
- kujdesen për sigurimin e kushteve teknike në punën e tyre.

Neni 27

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë hapësirat, bibliotekën dhe dokumentacionin e Komunës, për realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre.

7. Ndërprerja dhe marrja e mandatit të anëtarëve të Këshillit

Neni 28

Anëtarit të Këshillit i ndërpritet mandati në rastet e përcaktuara me ligj.

Neni 29

Anëtari i Këshillit ka të drejtë të parashtrojë dorëheqje dhe atë ta arsyetojë.

Dorëheqja i parashtrohet kryetarit i cili ua përcjell anëtarëve të Këshillit.

Dorëheqja mund të parashtrohet dhe të argumentohet në vetë mbledhjen e Këshillit.

Pas parashtrimit të dorëheqjes, Këshilli në mbledhjen rrjedhëse ose në mbledhjen e parë të ardhshme, pa diskutim, konstaton ndërprerjen e mandatit të anëtarit të Këshillit.

Kryetari i Këshillit e informon komisionin zgjedhor komunal, për ndërprerjen e mandatit të anëtarit të Këshillit.

Neni 30

Anëtarit të Këshillit i ndërpritet mandati kur do të punësohet në administratën komunale, si dhe kur ka marrë funksion gjegjësisht detyrë, e cila, sipas ligjit nuk ka lidhshmëri me kryerjen e funksionit anëtar i Këshillit.

Për paraqitjen e rastit të jolidhshmërisë, anëtari i Këshillit është i obliguar, menjëherë ta njoftojë kryetarin e këshillit.

Neni 31

Anëtarit të Këshillit do t'i merret mandati nëse tri herë radhazi mungon pa arsye në mbledhjet e Këshillit.

Neni 32

Kryetari i këshillit është i obliguar ta njoftojë Komisionin për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime dhe të inkuadrojë në propozimin e rendit të ditës për mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit, çdo rast që në vete tërheq ndërprerje të mandatit të ndonjë anëtari të Këshillit.

Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime është i obliguar ta shqyrtojë çdo rast që tërheq ndërprerje apo marrjen e mandatit të anëtarit të Këshillit, të kërkojë të dhëna nga institucionet dhe shërbimet kompetente për t'i vërtetuar faktet i dhe t'i vërtetojë shkaqet dhe ditën e paraqitjes së kushteve për ndërprerje ose marrjen e mandatit të anëtarit të Këshillit.

Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime është i obliguar që Këshillit t'i parashtroj raport dhe propozim për konstatimin e ndërprerjes ose sjelljen e vendimit për marrjen e mandatit të anëtarit të Këshillit.

Këshilli do ta përcaktojë shkakun dhe ditën e ndërprerjes së mandatit dhe nëse Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime, nuk paraqet raport dhe nuk jep propozim në lidhje me ngjarjen e ndodhur që tërheq ndërprerje ose marrjen e mandatit të anëtarit të Këshillit, dhe atë në bazë të dokumenteve që e vërtetojnë ndodhjen e kushteve të parashikuara me ligj për ndërprerjen dhe marrjen e mandatit të anëtarit të Këshillit, të siguruara nga ana e administratës komunale.

IV. KRYETARI I KËSHILLIT

1. Mënyra e zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit

Neni 33

Këshilli ka Kryetar i cili e përfaqëson Këshillin dhe ushtron punë të tjera të caktuara me ligj, Statutin e Komunës dhe me këtë Rregullore.

Neni 34

Kryetarin e Këshillit e zgjedh Këshilli me propozim të një ose një grup anëtarësh të Këshillit.

Këshilli voton për të gjitha propozimet e parashtruara, gjegjësisht për kandidatët e propozuar për zgjedhjen e kryetarit, përveç, për ata kandidatë të cilët kanë dhënë deklaratë se nuk e pranojnë kandidaturën.

2. Të drejtat dhe obligimet e Kryetarit të Këshillit

Neni 35

Kryetari i Këshillit:

- i thërret dhe udhëheq me mbledhjet e Këshillit;
- kujdeset për organizimin dhe punën e Këshillit;
- i nënshkruan vendimet dhe aktet e Këshillit dhe ia dorëzon Kryetarit të komunës për shpallje;
- jep iniciativë për diskutimimin e disa çështjeve nga fushëveprimi i Këshillit dhe komisioneve dhe kujdeset për harmonizimin e punës së tyre;
- nxit dhe ndihmon bashkëpunimin e ndërsjellë të komisioneve të Këshillit dhe kujdeset për bashkëpunimin e tyre me organet tjera;
- i cakton Mbledhjet e komisioneve, atëherë kur me kërkesën e anëtarëve të komisionit, mbledhjen nuk do ta caktojë kryetari i komisionit;
- kujdeset për zbatimin e rregullores;
- i interpreton dispozitat e rregullores;
- inicon dhe realizon bashkëpunim dhe koordinim me kryetarët e Këshillave të komunave tjera; dhe
- kryen edhe punë të tjera të caktuara me ligj, Statutin dhe me këtë rregullore.

Neni 36

Kryetari i Këshillit ka të drejtë të merr pjesë në punën e komisioneve të Këshillit dhe t'u propozojë të diskutojnë për çështje nga kompetencat e tyre.

Neni 37

Kryetari i Këshillit mundet, për shkak të organizimit të punës të Këshillit, të formojë Trup koordinues i cili:

- e planifikon dinamikën e mbledhjes së Këshillit, varësisht nga rëndësia, natyra dhe koha e parashtrimit të propozimeve të akteve dhe materialeve tjera;
- inicon rendin e ditës dhe kohën e mbajtjes së mbledhjeve të Këshillit;
- jep iniciativë Këshillit dhe komisioneve të diskutojnë për çështje nga kompetencat e tyre.

Trupi koordinues përbëhet nga një anëtar i Këshillit si përfaqësues i listës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, që në pajtim me raportin e komisionit zgjedhor komunal, ka marrë mandate në zgjedhjet e mbajtura lokale. Grup këshillues I përbërë prej më së paku 3 anëtarëve në Këshill.

3. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit me votim publik

Neni 38

Kryetarin e Këshillit e zgjedh Këshilli me votim publik, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Neni 39

Nëse janë propozuar më shumë kandidatë për kryetar të Këshillit, i zgjedhur është kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Neni 40

Këshilli voton veç e veç për secilin kandidat të propozuar.

Neni 41

Kryetari i Këshillit i thërret anëtarët e Këshillit që të deklarohen "për" propozimin, pa thërritje të deklarohen "kundër", gjegjësisht "të përmbajtur".

Anëtari i Këshillit në procedurën për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit me votim publik, ka të drejtë të përcaktohet gjegjësisht të votojë "për" vetëm për njërin kandidat.

Neni 42

Nëse në rrethin e parë asnjëri prej kandidatëve për Kryetar të Këshillit nuk e ka fituar shumicën e votave të nevojshme, fillon qasja drejt rrethit të dytë të votimit për dy kandidatët, të cilët në rrethin e parë kanë fituar numër më të madh votash.

Neni 43

Nëse në rrethin e parë disa kandidatë kanë fituar numër të njëjtë votash, për arsye se nuk mund të caktohen dy kandidatë që kanë numër më të madh votash, votimi përsëritet vetëm për kandidatët që kanë numër të njëjtë votash, me qëllim që të përcaktohen dy kandidatë për të cilët do të votohet në rrethin e dytë.

Neni 44

Nëse edhe pas rrethit të dytë asnjëri nga dy kandidatët nuk e fiton numrin e nevojshëm të votave, atëherë përsëritet procedura për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit.

4. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit me votim të fshehtë

Neni 45

Zgjedhja e kryetarit të Këshillit mund të bëhet me votim të fshehtë, nëse për propozimin e tillë të anëtarit të Këshillit vendos Këshilli me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Neni 46

Me votimin e fshehtë udhëheq komisioni të cilin e zgjedh Këshilli me propozimin e anëtarëve të Këshillit, i cili ka propozuar që votimi të jetë i fshehtë.

Neni 47

Votimi i fshehtë për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit bëhet me fletëvotime.

Në fletëvotimin për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit, shkruhen emrat dhe mbiemrat e personave të propozuar për zgjedhje, gjegjësisht shkarkim edhe atë sipas radhës së propozimeve të paraqitura.

Në fletëvotim, para emrit të kandidatit vihet numër rendor.

Neni 48

Fletëvotimet duhet të jenë të madhësisë, ngjyrës dhe formës së njejtë.

Në çdo fletëvotim vihet vula e Komunës.

Neni 49

Çdo anëtarë i Këshillit merr nga një fletëvotim.

Pasi që të vërtetohet se të gjithë anëtarët e Këshillit kanë marrë nga një fletëvotim, Kryesuesi do t'i jep sqarimet e nevojshme për mënyrën e votimit dhe do ta caktojë kohën e nevojshme për plotësimin e fletëvotimit.

Neni 50

Anëtari i Këshillit voton në atë mënyrë që e rrethon numrin rendor para emrit dhe mbiemrit të kandidatit për të cilin voton dhe personalisht fut fletëvotimin në kutinë e votimit, të paluar ashtu që të sigurojë fshehtësinë e votimit.

Neni 51

Pasi të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit do të votojnë dhe pasi që kryesuesi do të kumtojë se votimi ka përfunduar, kalohet në përcaktimin e rezultateve të votimit.

Rezultatet e votimit vërtetohen në bazë të fletëvotimeve të dorëzuara.

Neni 52

Fletëvotimi nga i cili nuk mund të përcaktohet qartë për cilin kandidat është votuar (janë rrethuar më shumë kandidatë, janë shlyer emrat e një ose më shumë kandidatëve, fletëvotimi është korrigjuar, çkyer ose nuk është plotësuar), llogaritet i pavlefshëm.

Neni 53

Pas përfundimit të votimit dhe numërimit të fletëvotimeve, kryetari i komisionit do ta shpall rezultatin e votimit dhe do të kumtojë sa anëtarë të Këshillit gjithsej kanë marrë fletëvotime, sa kanë votuar, dhe sa vota ka fituar secili kandidatë.

Neni 54

Në bazë të raportit të komisionit, kryesuesi do të konstatojë, cili kandidat është zgjedhur për kryetar të Këshillit.

Neni 55

Nëse, asnjëri prej kandidatëve nuk është zgjedhur për kryetar të Këshillit në rrethin e parë të votimit, gjegjësisht nuk e ka fituar shumicën e votave të nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, kryesuesi do të konstatojë për cilët dy kandidatë, që kanë fituar numër më të madh votash në rrethin e parë të votimit do të votohet në rrethin e dytë.

Nëse në rrethin e parë më shumë kandidatë kanë fituar të njejtin numër votash, për shkak se nuk mund të caktohen dy kandidatë që kanë numër më të madh votash, votimi përsëritet vetëm për kandidatët që kanë numër të njejtë votash, me qëllim që të caktohen dy kandidatë për të cilën do të votohet në rrethin e dytë.

Neni 56

Në procedurën dhe mënyrën e votimit në rrethin e dytë, me dy kandidatë, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje sa i përket votimit në rrethin e parë.

Neni 57

Nëse asnjëri nga dy kandidatët në rrethin e dytë nuk ka fituar shumicën e nevojshme, procedura zgjedhore përsëritet në tërësi.

V. PUNA E KËSHILLIT

1. Konvokimi mbledhjeve

Neni 58

Këshilli punon në mbledhje të cilat i konvokon Kryetari i Këshillit, me iniciativën e tij.

Në rast pengimi apo mungese të Kryetarit të Këshillit, mbledhjet i thërret anëtari më i vjetër i Këshillit.

Mbledhja e Këshillit, në pajtim me ligjin, mund të konvokohet edhe në kërkesë të Kryetarit të komunës, si dhe me kërkesën e më së paku ¼ së anëtarëve të Këshillit, në afat prej 15 ditësh nga parashtrimi i kërkesës.

Nëse kryetari i Këshillit nuk e cakton mbledhjen me kërkesën e anëtareve të Këshillit, mbledhjen mund ta konvokojnë parashtruesit e kërkesës, ta propozojnë rendin e ditës së mbledhjes, kurse mbledhjen ta udhëheq kryetari të cilin do ta zgjedh Këshilli për atë mbledhje.

Neni 59

Ftesë për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit u dërgohet të gjithë anëtarëve të Këshillit, më së voni 7 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes.

Bashkë me ftesën, anëtarëve të Këshillit u dorëzohet propozimi i rendit të ditës dhe materiali gjegjës për çështjet që propozohen në rendin e ditës.

Me përjashtim, në raste urgjente, të përcaktuara me Statutin, Kryetari i Këshillit mund të thërrasë seancë të jashtëzakonshme edhe në afat kohor prej më pak se 7 ditësh kurse rendin e ditës ta propozojë në vet mbledhjen.

2. Rendi i ditës

Neni 60

Rendi i ditës të mbledhjes së Këshillit përcaktohet me propozimin e Kryetarit të Këshillit në fillim të mbledhjes, me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit.

Në propozimin e rendit të ditës, Kryetari i Këshillit i vendos të gjitha çështjet të cilat deri në ditën e thërritjes së mbledhjes i janë dorëzuar nga ana e Kryetarit të komunës apo nga propozues tjerë.

Neni 61

Çdo anëtar i Këshillit në seancë mund të propozojë:

- të ndryshohet radhitja e propozuar e pikave të rendit të ditës;
- ndonjë nga pikat e propozuara të hiqet nga rendi i ditës;
- rendi i ditës të plotësohet me pikë të re të rendit të ditës, por është i obliguar ta sqarojë urgjencën e atij propozimi.

Kryetari i komunës mund të propozojë plotësimin e rendit të ditës të mbledhjes me ndonjë çështje të caktuar kurse urgjencën ta sqarojë Kryetari i komunës apo përfaqësuesi të cilin ai do ta autorizojë.

Këshilli me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm vendos veç e veç për secilin propozim për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës së propozuar.

Nëse është pranuar propozimi për heqjen e ndonjë pike të propozuar nga rendi i ditës, nuk mund të kërkohet kthim i sërishëm i asaj pike në rendin e ditës.

3. Kryesimi dhe pjesëmarrja

Neni 62

Me mbledhjen e Këshillit kryeson Kryetari i Këshillit.

Në rast të pamundësisë apo mungesës së tij, e zëvendëson anëtari më i vjetër i Këshillit.

Nëse anëtari më i vjetër i Këshillit nuk është i pranishëm ose mungon për ndonjë arsye, me mbledhjen kryeson anëtari i Këshillit, të cilin me propozimin e një anëtari apo një grupi anëtarësh të Këshillit do ta zgjedh Këshilli me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit.

Neni 63

Në punën e mbledhjes së Këshillit, pa të drejtë vendosjeje, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të ftuar të shërbimeve publike, institucioneve dhe ndërmarrjeve.

Neni 64

Në mbledhjen e Këshillit askush nuk mund të flasë para se të kërkojë dhe të merr fjalën nga kryetari.

Paraqitjet për fjalë bëhen pasiqë të fillojë diskutimi dhe mund të paraqiten deri në përfundimin e tij.

Neni 65

Anëtari i Këshillit flet nga foltorja ose nga vendi i tij nëse ka kushte teknike që të gjithë të pranishmit ta përcjellin ekspozenë e tij.

Nëse në punën e Këshillit, shfrytëzohet gjuhë tjetër, gjatë diskutimit sigurohet përkthimi, që të munden të pranishmit në mbledhje ta përcjellin diskutimin.

Neni 66

Kryetari kujdeset, që anëtari i Këshillit të mos pengohet gjatë fjalës së tij.

Anëtarit të Këshillit mund ti bëjë vërejtje apo t'ia ndërpresë fjalën vetëm kryetari.

Neni 67

Kryetari u jep fjalë anëtarëve të Këshillit sipas radhës së paraqitjes së tyre.

Kryetari menjëherë do t'ia jep fjalën anëtarit të Këshillit i cili dëshiron ta merr fjalën lidhur me zbatimin ose shmangies nga dispozitat e Rregullores (pyetje procedurale) apo rendit të përcaktuar të ditës.

Fjala e këtij anëtari të Këshillit nuk mund të zgjasë më tepër se 3 minuta.

Pas diskutimit të anëtarit të Këshillit, Kryetari është i obliguar të jep sqarime.

Nëse anëtari i Këshillit nuk është i kënaqur nga sqarimi i dhënë, për atë çështje vendoset në mbledhje pa debat.

Neni 68

Kryetari do t'ia jep fjalën anëtarit të Këshillit nëse ai kërkon fjalë (replikë) që ta përmirësojë të dhënën të paraqitur josaktësisht ose ngase ka dhënë rast për mosmarrëveshje apo ka shkaktuar nevojë për t'u sqaruar personalisht edhe atë, pasi që ta përfundojë diskutimin ai që e ka shkaktuar nevojën për replikë.

Në replikën e vet, e cila nuk mund të zgjasë më tepër se 2 minuta, anëtari i Këshillit patjetër duhet të kufizohet në përmirësimin, gjegjësisht në sqarimin e tij personal.

Anëtari i Këshillit të cilit i është drejtuar replika, ka të drejtë të përgjigjet në kohëzgjatje prej 1 minute.

Anëtari i Këshillit, të drejtën e replikës dhe përgjigjen për replikën mund ta shfrytëzojë vetëm një herë gjatë debatit për një pikë të rendit të ditës.

Neni 69

Anëtari i Këshillit mund të flasë vetëm për çështjet që janë në rend të ditës.

Nëse anëtari i Këshillit largohet nga rendi i ditës, kryetari do ta thërret që t'i përmbahet rendit të ditës.

Nëse anëtari i Këshillit edhe pas vërejtjes së sërishme nuk i përmbahet rendit të ditës, kryetari mund t'ia marrë fjalën.

4. Kufizimi i kohëzgjatjes së diskutimit

Neni 70

Me propozimin e Kryetarit ose ndonjë anëtari të Këshillit, të cilin e përkrahin më se paku 5 anëtarë të Këshillit, mund të vendos, me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit, për të njejtën çështje në mbledhje të flitet vetëm një herë, si dhe të caktohet kohëzgjatja e diskutimit, që nuk mund të jetë më shumë se 5 minuta.

5. Mbajtja e rendit

Neni 71

Për mbajtjen e rendit gjatë mbledhjes kujdeset kryetari.

Neni 72

Për cënimin e rendit të mbledhjes, kundër anëtarit të Këshillit i cili e cënon rendin, mund të shqiptohen masat vijuese: vërejtje, marrja e fjalës dhe largimi nga mbledhja.

Masat e shqiptuara shënohen në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 73

Vërejtje do t'i shqiptohet anëtarit të Këshillit i cili në diskutimin e tij largohet nga rendi i ditës, i cili me sjelljen e tij, me marrjen e fjalës kur Kryetari nuk ia ka dhënë fjalën, me ndërhyrjen në fjalë, ose me ndonjë veprim të ngjashëm prish rendin e mbledhjes dhe të dispozitave të kësaj rregulloreje.

Marrja e fjalës do t'i shqiptohet anëtarit të Këshillit, i cili me fjalën e tij gjatë mbledhjes cënon rendin dhe dispozitat e kësaj rregulloreje, kurse në të njejtën seancë dy herë ka marrë vërejtje që të mos e prish rendin e mbledhjes dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.

Masat, vërejtjet dhe marrjen e fjalës, ia shqipton Kryetari.

Neni 74

Masa, përjashtimi nga mbledhja i shqiptohet anëtarit të Këshillit që nuk do të veprojë sipas kërkesës së Kryetarit I cili ia ka shqiptuar masën, marrjen e fjalës ose në ndonjë mënyrë tjetër e pengon punën e mbledhjes ose e ofendon Këshillin ose anëtarët e tij, ose gjatë fjalimit përdor shprehje me të cilën cenohet dinjiteti I anëtarëve të Këshillit.

Anëtari I Këshillit mund të largohet nga séancë vetëm kure shkel rendin.

Neni 75

Masën, përjashtimin nga mbledhja mund ta propozojë Kryetari I Këshillit ose anëtari I Këshillit.

Anëtarit të këshillit ndaj të cilit i propozohet shqiptim i masës përjashtim nga mbledhja ka të drejtë fjale, gjatë të cilit fjalimi nuk mund t'i zgjasë më shumë se 3 minuta.

Masën, përjashtimin nga séanca e shqipton Këshilli pa diskutim, me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit.

Anëtarit të Këshillit të cilit i është shqiptuar masa përjashtim nga Mbledhja është i obliguar menjëherë të përjashtohet nga Mbledhja dhe nuk mundet më shumë të merr pjesë në seancë nga e cila është përjashtuar.

Neni 76

Nëse me masa të rregullta nuk mundet të mbahet rendi i mbledhjes, kryetari do ta ndërpres atë.

Neni 77

Kryetari mund të urdhërojë që nga salla, në të cilën mbahet mbledhja, të mënjanohet secilin që cënon rendin.

Neni 78

Të gjithë personat që gjenden në hapësirat e Këshillit, për derisa zgjat Mbledhja, zyrtarisht janë të obliguar t'i kryejnë urdhrat e Kryetarit sa i takon mbajtjes së rendit.

6. Rrjedha e mbledhjes

Neni 79

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë, para se të përcaktohet rendit të ditës së mbledhjes, t'i bëjnë vërejtje procesverbalit nga Mbledhja e kaluar.

Për atë se sa janë me bazë vërejtjet, vendos Këshilli pa debat, e nëse vërejtjet miratohen, në procesverbal do të kryhen ndryshimet e duhura.

Neni 80

Pas miratimit të rendit të ditës, Kryetari i informon anëtarët e Këshillit për materialet e dorëzuara në mënyrë plotësuese ose të shpërndara para mbledhjes dhe jep informata të tjera të rëndësishme për punën e mbledhjes e që duhet të merren parasysh gjatë vendosjes.

Neni 81

Mbledhja mbahet sipas rendit të përcaktuar të ditës, kurse Kryetari është i obliguar të hap debat për çdo pikë të rendit të ditës, përveç nëse me ligj, Statutin dhe me këtë rregullore është përcaktuar të vendoset pa debat.

Këshilli me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm, mund të vendos me propozimin e Kryetarit të komunës apo anëtarit të Këshillit, të zhvillojë debat të përbashkët për shumicën e pikave të rendit të ditës, nëse ato kanë përmbajtje të ngjashme ose kanë lidhshmëri midis tyre, por votimi patjetër duhet të bëhet në veçanti.

Këshilli me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm mund të vendos me propozimin e kryetarit të komunës ose anëtarit të Këshillit, të bëhet ndryshimi i rendit të debatit për pikat nga rendi i ditës së miratuar.

Neni 82

Diskutimi për çështje të caktuar zgjat dhe zhvillohet derisa për të ka të paraqitur për fjalë.

Kryetari përmbyll diskutimin pasi ta vërtetojë se nuk ka më të paraqitur për fjalë.

Neni 83

Debati për disa çështje është unik.

Gjatë debatit së pari diskutohet për amendamentet nëse të tilla janë paraqitur sipas propozimit.

7. Shumicë për punë

Neni 84

Këshilli mund të punojë nëse në mbledhje janë të pranishëm shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Nëse Kryetari konsideron se në mbledhje nuk është i pranishëm numri i mjaftueshëm i anëtarëve të Këshillit, do të kërkojë që të lexohen emrat e anëtarëve.

Leximi i emrave bëhet edhe nëse atë e kërkon ndonjë anëtar i Këshillit.

Nëse vërtetohet se në mbledhje nuk janë të pranishëm shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, Mbledhja nuk mund të mbahet gjegjësisht nëse ka filluar, ndërpritet.

Në rastet e paragrafit 4 të këtij neni, kryetari e ricakton mbledhjen, me njoftim elektronik ose me sms porosi dërguar tek të gjithë anëtarët e Këshillit.

8. Vendosja

Neni 85

Të plotfuqishme janë vendimet për të cilat ka votuar shumica e nevojshme e anëtarëve të Këshillit, përcaktuar me ligj, Statutin dhe këtë rregullore.

Neni 86

Anëtarët e këshillit votojnë në atë mënyrë që deklarohen "për" apo "kundër" propozimit ose janë të përmbajtur në votim.

Neni 87

Votimi publik bëhet me shfrytëzimin e sistemit adekuat elektronik, me ngritjen e dorës ose me deklarimin individual gojor.

Neni 88

Votimi me përdorimin e sistemit adekuat elektronik, bëhet në mënyrë që mundëson, secili anëtar i Këshillit të votojë dhe të evidentojë çdo votë të dhënë "për", "kundër" apo "të përmbajtur", dhe ta përcaktojë numrin e votave, gjegjësisht rezultatin e votimit.

Neni 89

Votimi me ngritjen e dorës bëhet në atë mënyrë që kryetari i thërret anëtarët e Këshillit së pari të deklarohen, cilët janë "për" propozimin, pastaj të deklarohen cilët janë "kundër" propozimit dhe në fund të deklarohen ata që janë "të përmbajtur".

Neni 90

Votimi emër për emër bëhet kur kryetari konsideron se nevojitet saktësisht të përcaktohet rezultati i votimit.

Votimi emër për emër bëhet edhe atëherë kur atë do ta kërkojë anëtari i Këshillit.

Gjatë këtij lloj votimi anëtarët e Këshillit, gojarisht deklarohen se janë "për", "kundër" ose "të përmbajtur".

Leximin e emrave e bën nëpunësi i administratës komunale.

Neni 91

Votimi i fshehtë bëhet me fletëvotime.

Me votimin e fshehtë udhëheq komisioni të cilin e zgjedh Këshilli me propozimin e anëtarit të Këshillit, i cili ka propozuar që votimi të jetë i fshehtë.

Neni 92

Nëse votimi i fshehtë është për miratimin e dispozitës nga kompetenca të Këshillit, në fletëvotim saktësisht shkruhet titulli I dispozitës dhe i mundësohet anëtarit të Këshillit të votojë "për", "kundër" ose "i përmbajtur".

Neni 93

Nëse votimi fshehtë bëhet për zgjedhje apo shkarkim, në fletëvotim shënohen emrat e personave të propozuar për zgjedhje, gjegjësisht shkarkim edhe atë sipas radhës së propozimeve të paraqitura.

Në fletëvotimin për zgjedhje ose shkarkim, para emrit të kandidatit, vihet numër rendor.

Neni 94

Fletëvotimet duhet të jenë të së njejtës formë, ngjyre dhe madhësie.
Në çdo fletëvotim vihet vula e Komunës.

Neni 95

Secili anëtar I Këshillit merr nga një fletëvotim.
Pasi të vërtetohet se të gjithë anëtarët e Këshillit kanë marrë nga një fletëvotim, Kryetari do t'i jep sqarimet e nevojshme për mënyrën e votimit dhe do ta caktojë kohën e nevojshme për plotësimin e fletëvotimeve.
Pas skadimit të kohës së caktuar, Kryetari i thërret anëtarët e Këshillit të votojnë.

Neni 96

Anëtari i Këshillit personalisht e fut fletëvotimin në kutinë e votimit, të paluar ashtu që të sigurojë fshehtësinë e votës së dhënë.

Neni 97

Gjatë votimit për zgjedhje, anëtari i Këshillit voton në atë mënyrë që e rrethon numrin rendor para emrit dhe mbiemrit të kandidatit për të cilin voton.
Gjatë votimit për shkarkim, anëtari i Këshillit voton në atë mënyrë që e rrethon numrin rendor para emrit dhe mbiemrit të personit për shkarkimin e të cilit votohet.
Fletëvotimi nga i cili nuk mund të përcaktohet qartë, gjegjësisht për çka është votuar, llogaritet i pavlefshëm.

Neni 98

Pasi të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit do të votojnë dhe pasi kryetari do ta shpallë votimin të përfunduar, kalohet në përcaktimin e rezultateve nga votimi.
Rezultatet e votimit caktohen në bazë të fletëvotimeve të dorëzuara.

Neni 99

Pas përfundimit të votimit dhe numërimit të fletëvotimeve, kryetari i komisionit do ta shpallë rezultatin e votimit në të njëjtën mbledhje të Këshillit dhe do të kumtojë sa anëtarë të Këshillit gjithsej kanë votuar, sa kanë qenë "për", "kundër" ose "të përmbajtur" dhe sa fletëvotime të pavlefshme ka.

9. Procesverbalet

Neni 100

Për punën e mbledhjes së Këshillit mbahet procesverbal.

Procesverbali përmban të dhënat themelore për punën e mbledhjes, posaçërisht për numrin e të pranishmëve, emrat dhe mbiemrat e anëtarëve të Këshillit që mungojnë me arsye, rendin e ditës të miratuar në mbledhje, propozimet dhe amendamentet e parashtruara në mbledhje si dhe për vendimet që janë miratuar.

Në procesverbal regjistrohen rezultatet e votimit për çështje të caktuara.

Anëtari i Këshillit i cili në mbledhje ka ndarë mendim, mund të kërkojë që në procesverbal të futen pjesët e rëndësishme të deklaratës së tij.

Neni 101

Procesverbali u dërgohet anëtarëve të Këshillit, bashkë me ftesën për mbajtjen e mbledhjes së radhës.

Neni 102

Procesverbali në të cilin gjenden vërejtjet, respektivisht procesverbali në të cilin në pajtim me vërejtjet e miratuara janë bërë ndryshime, konsiderohet e miratuar.

Procesverbalin e miratuar e nënshkruan Kryetari i Këshillit.

Për hartimin e procesverbalit dhe për ruajtjen e shënimeve origjinale të mbledhjes së Këshillit, kujdeset administrata komunale.

10. Shënimet stenografike

Neni 103

Për punën e mbledhjes së Këshillit sigurohet shënime stenografike, kurse sipas nevojës bëhet edhe inçizim tonik ose video-inçizim.

Pjesë përbërëse e shënimeve stenografike janë edhe fjalimet e palexuara të anëtarëve të Këshillit të cilët në seancë gjatë debatit i kanë dorëzuar me shkrim.

Shënimet stenografike u shpërndahen anëtarëve të Këshillit, me kërkesën e tyre.

Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të kërkojë që në shënimet stenografike të bëhen korrigjime të fjalës së tyre, por pa ndryshime qenësore.

Për realizimin e kësaj të drejte të anëtarëve të Këshillit, kujdeset Kryetari i Këshillit.

Nëse paraqitet kontest për bazën e kërkesës të bëhet korrigjim në shënimet stenografike, për kërkesën vendoset gjatë mbledhjes pa debat.

Shënimet stenografike për punën e Këshillit ruhen në dokumentacionin e administratës komunale.

VI. KOMISIONET E KËSHILLIT

1. Komisionet e përhershme dhe të përkohshme

Neni 104

Këshilli formon komisione të përhershme dhe të përkohshme.

Neni 105

Komisionet e përhershme në kuadër të fushëveprimit të tyre:

- i shqyrtojnë propozimet për miratimin e dispozitave dhe akteve tjera nga kompetenca e Këshillit dhe I parashtrojnë raport për qëndrimet, mendimet dhe propozimet e tyre;
- studiojnë dhe shqyrtojnë çështje të tjera nga fushëveprimi tyre dhe Këshillit i japin mendime dhe propozime në lidhje me ato çështje.

Neni 106

Këshilli i formon komisionet e përkohshme për të studijuar çështje të caktuara që nuk bëjnë pjesë në fushëveprimin e komisioneve të përhershme, si dhe në raste të tjera, kur për atë do të paraqitet nevoja.

Komisioni i përkohshëm pushon me punë kur do ta kryejë detyrën për të cilën është formuar dhe në raste të tjera, kur Këshilli do të vendos për atë.

2. Përbërja e komisioneve

Neni 107

Numri i anëtarëve të komisioneve të përhershme përcaktohet me Statut.

Përbërja, numri i anëtarëve dhe detyrat e komisioneve të përkohshme përcaktohet me aktin për formimin e trupit (organit).

Anëtarë të komisioneve të përkohshme mund të jenë, përveç anëtarëve të Këshillit, edhe punonjës shkencorë edhe profesional.

Neni 108

Komisionet e përhershme dhe të përkohshme kanë kryetar dhe numër të caktuar anëtarësh.

Kryetari i komisionit të përhershëm dhe të përkohshëm:

- e organizon punën e komisionit;
- jep iniciativë për diskutimin e disa çështjeve nga fushëveprimi i komisionit;
- kujdeset për njoftimin e anëtarëve të komisionit dhe të Këshillit për problemet e fushëveprimit të komisionit;
- i përgatit mbledhjet;
- i konvokon mbledhjet ose autorizon nëpunës udhëheqës nga administrata
- propozon rendin e ditës së mbledhjeve dhe kryeson me to;
- kujdeset për zbatimin e konkluzioneve, dhe
- ushtron edhe punë të tjera që janë të përcaktuara me këtë rregullore.

Në rast pengese apo mosprezence në mbledhje, kryetari e zëvendëson anëtarin i komisionit.

3. Mënyra e punës

Neni 109

Komisionet punojnë në mbledhja.

Kryetari i komisionit është i obliguar t'i konvokojë Mbledhjet nëse në rendin e ditës së mbledhjes së këshillit është vënë në rend dite çështje në kompetencë të komisionit, nëse atë e kërkon kryetari i Këshillit ose atë e kërkojnë më së paku 3 anëtarë të komisionit, duke theksuar çështjen e cila duhet të vihet në rendin e ditës së mbledhjes.

Nëse kryetari nuk thërret mbledhje atëherë kur është i obliguar atë ta bëjë, mbledhjen është i obliguar ta thërret kryetari i Këshillit.

Nëse me kërkesën e më pak 3 anëtarëve të komisionit, seancë nuk thërret as Kryetari i komisionit, e as Kryetari i Këshillit, mbledhjen do ta caktojnë anëtarët e komisionit të cilët e kanë kërkuar atë.

Ftesën për mbledhje me propozim rendin e ditës dhe materialet që do të shqyrtohen në mbledhje, kryetari i komisionit ua dorëzon anëtarëve të komisionit më së voni 5 ditë para datës së mbajtjes së mbledhjes.

Me përjashtim, kryetari mund të thërrasë mbledhje edhe në afat më të shkurtër kohor.

Kryetari i komisionit i njofton propozuesit e materialeve të cilat do t'i diskutojë komisioni, me qëllim që të caktojnë përfaqësues të cilët do të marrin pjesë në seancë.

Neni 110

Procesverbalet dhe raportet nga Mbledhja e komisionit i nënshkruan Kryetari i komisionit.

Neni 111

Iniciativë për inkuadrimin e çështjeve të caktuara në propozimin e rendit të ditës së mbledhjes të komisionit, mund të japin anëtarët e Këshillit, komisione tjera të Këshillit si dhe shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet e themeluara nga Komuna Jegunovcit.

Neni 112

Debati në lidhje me çështjet që janë në rendin e ditës të mbledhjes së komisionit, mund të përfundojë me kalim të thjeshtë në pikën vijuese të rendit të ditës ose me sjelljen e konkluzionit, për çka në Këshill mund t'i parashtrojë raport.

Neni 113

Komisioni mund t'i propozojë Këshillit ta anulojë debatin për disa çështje të cilat komisioni i ka shqyrtuar e të cilat i përmban propozimi i rendit të ditës për séancën e Këshillit.

Neni 114

Komisionet e Këshillit inicojnë shqyrtimin e çështjeve nga fushëveprimi i tyre me iniciativën e tyre kurse janë të obliguar ta shqyrtojnë secilën çështje nga fushëveprimi i tyre, shqyrtimin e së cilës do ta kërkojë Kryetari i Këshillit dhe Kryetari i komunës.

Neni 115

Rendi i ditës së mbledhjes së komisionit caktohet në fillim të mbledhjes.

Neni 116

Komisionet mund të punojnë nëse në mbledhje janë të pranishëm shumica e anëtarëve të komisionit.

Komisionet vendosin me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të komisionit.

Neni 117

Kur do të vendos t'i parashtrojë raport apo propozim Këshillit, komisioni cakton raportuesin e vet i cili me direktivën e komisionit, me iniciativën e vet ose me

kërkesën e Këshillit, në mbledhjen e Këshillit do ta arsyetojë qëndrimin apo propozimin e komisionit.

Neni 118

Në mbledhjen e komisionit patjetër merr pjesë përfaqësues i propozuesit.

Përfaqësuesi i propozuesit ka të drejtë që në mbledhjen e komisionit të merr pjesë dhe të diskutojë për propozimin që e ka paraqitur.

Neni 119

Komisioni ka të drejtë të kërkojë nga propozuesi njoftim, sqarim si dhe të dhëna që i nevojiten për punë të cilat i posedon propozuesi ose është i obliguar ti grumbullojë dhe evidentojë.

Neni 120

Komisioni mundet në Mbledhjet e veta të thërrasë përfaqësues të organeve, organizatave, bashkësive dhe shoqatave, si dhe punonjës shkencorë, profesional dhe publik, ashtu që ata t'i paraqesin mendimet e tyre për çështjet që shqyrtohen në mbledhjen e komisionit.

4. Fushëveprimi i Komisioneve të përhershme të Këshillit

Neni 121

Këshilli I ka komisionet e përhershme vijuese:

- Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime
- Komisioni për Statut dhe dispozita
- Komisioni për financa, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal
- Komisioni për urbanizëm, veprimtari publike dhe komunale dhe mbrojtje e mjedisit jetësor
- Komisioni për veprimtari shoqërore
- Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive
- Komisioni për mundësi të barabarta midis burrave dhe grave

a.) Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime

Neni 122

Komisioni për çështje mandatore,zgjedhje dhe emërime shqyrton dhe përgatit propozime të cilat u përkasin çështjeve të mandatit dhe imunitetit.

Shqyrton dhe përgatit propozime për zgjedhje,emërime dhe shkarkime në kompetencë të Këshillit të Komunës.

Cakton rroga,kompensime dhe të ardhura të tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar.

Jep propozim për lartësinë e kompensimit të harxhimeve për udhëtime dhe të mëditjeve të anëtarëve të Këshillit të Komunës,si dhe të harxhimeve të bëra në kryerjen e detyrave që ua ka besuar Këshilli i Komunës.

b.)Komisioni për Statut dhe dispozita

Neni 123

Komisioni për statut dhe dispozita përcakton propozimin e statutit të komunës,shqyrton nismat dhe propozimet për ndryshimin e statutit,përcjell zbatimin e tij dhe i shqyrton çështjet parimore me karakter statutar.

Përcakton propozimin e rregullores së Këshillit.

Përgatit propozim mendime për propozim ligjet që i përkasin komunës.

Shqyrton edhe akte të tjera të përgjithshme në kompetencë të Këshillit të Komunës.

c.) Komisioni për financa, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal

Neni 124

Komisioni për Financa, Buxhet dhe Zhvillim Ekonomik Lokal ndjek, shqyrton dhe analizon çështjet që lidhen me financimin e komunës; shqyrton projekt dhe propozim buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të Buxhetit; ndjek gjendjen me realizimin e të ardhurave themelore të Komunës dhe realizon mbikëqyrje mbi realizimin e shpenzimeve të planifikuara; shqyrton çështjet në fushën e zhvillimit ekonomik lokal dhe propozon masa brenda fushëveprimit të tij.

ç.) Komisioni për urbanizëm, veprimtari publike dhe komunale dhe mbrojtje e mjedisit jetësor

Neni 125

Komisioni për Urbanizëm, veprimtari Komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor

shqyrton çështjet që lidhen me urbanizmin, rregullimin e tokës ndërtimore, mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor (mbrojtja nga ndotja e ajrit dhe ujit dhe parandalimi i zhurmës së dëmshme), mbrojtjen nga zjarri, shqyrton çështjet në fushën e aktiviteteve komunale, trafikun, shqyrton çështjet që lidhen me emërtimin e rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore, si dhe shënimin e tyre, dhe shqyrton propozimet për emërtimin e rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore dhe i paraqet një propozim Këshillit.

d.) Komisioni për veprimtari shoqërore

Neni 126

Komisioni për veprimtari shoqërore shqyrton çështje brenda kompetencës së komunës, në fushën e kulturës dhe i jep Këshillit iniciativa, mendime dhe propozime, në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në program; zhvillimin e institucioneve; mundësitë për themelimin, financimin e ndërtimit, pajisjen dhe mirëmbajtjen e institucioneve në përputhje me ligjin; çështjet që lidhen me themelimin, financimin e ndërtimit, pajisjen dhe mirëmbajtjen e institucioneve në fushën e sportit, çështjet në fushën e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit parashkollor, arsimit fillor dhe të mesëm, kujdesit shëndetësor primar dhe çështje të tjera në fushën e aktiviteteve sociale dhe i jep Këshillit mendime dhe propozime.

dh.) Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive

Neni 127

Komisioni i shqyrton çështjet që u përkasin marrëdhënieve ndërmjet bashkësive të përfaqësuara në komunë dhe jep mendime e propozime për mënyrën e zgjidhjes së tyre.

e.) Komisioni për mundësi të barabarta midis burrave dhe grave

Neni 128

Komisioni për mundësi të barabarta midis burrave dhe grave shqyrton çështjet që lidhen me barazinë gjinore midis burrave dhe grave, si dhe siguron përfaqësimin e grave në hartimin e politikave, zhvillimin komunal dhe përfaqësimin në sferën e jetës shoqërore.

5. Fushëveprimi i Komisioneve të përkohshme të Këshillit

Neni 129

Komisione të përkohshme Këshilli formon për të studiuar një çështje specifike që nuk hyn në fushëveprimin e komisioneve të përhershme, si dhe në raste të tjera kur lind nevoja.

Komisioni i përkohshëm pushon së vepruari kur ka përfunduar detyrën për të cilën është krijuar dhe në raste të tjera kur Këshilli vendos kështu.

5. Dispozitat e posaçme për zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve

Neni 130

Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit të Këshillit bëhet tërësisht në bazë të listave të propozuara.

Listë mund të propozojë secili anëtar i Këshillit apo një grup këshilltarësh.

Lista e propozuar vihet në rendin e ditës të mbledhjes së Këshillit vetëm nëse të gjithë kandidatët e propozuar për anëtarë të komisionit, kanë dhënë deklaratë me të cilën e pranojnë kandidaturën.

Listat e kandidatëve i dorëzohen Kryetarit të Këshillit i cili ia dorëzon Komisionit për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime.

Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit bëhet me votim publik, me shumicë të anëtarëve të pranishëm të Këshillit.

Neni 131

Zgjedhja për shkak të ndërrimit të ndonjë anëtari të komisionit bëhet në bazë të propozimeve individuale, me votim publik, me shumicë të anëtarëve të pranishëm të Këshillit.

Neni 132

Propozim për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit mund të jep komisioni, një anëtarë i Këshillit apo kryetari i Këshillit.

Për propozimin për shkarkim vendos Këshilli, me votim publik, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit.

VII. PROGRAMIMI I PUNËS

Neni 133

Puna e Këshillit zhvillohet sipas programit për punën e Këshillit.

Programin e punës e miraton Këshilli për një vit kalendarik me propozimin e komisionit të cilin e formon Këshilli nga radhët e anëtarëve të vet.

Neni 134

Bazë për përpilimin e programit për punën e Këshillit janë punët që me ligj janë vënë në kompetencat e Këshillit.

Neni 135

Propozime për përfshirjen e detyrave dhe punëve të caktuara në programin e punës së Këshillit mund të paraqesin:

- anëtarët e Këshillit, komisionet, trupat e posaçme të Komunës dhe Kryetari i komunës;
- organet e administratës shtetërore;
- shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet e themeluara nga Komuna,
- ndërmarrjet publike që kryejnë punë me rëndësi dhe interes për Komunën;
- format e vetëqeverisjes vendore;
- shoqatat e qytetarëve; dhe
- subjekte tjera të interesuar.

Neni 136

Programi i punës së Këshillit posaçërisht përmban:

- emrin e vendimeve dhe akteve tjera të përgjithshme dhe çështjeve, gjegjësisht temat që do t'i shqyrtojë Këshilli;
- subjektet e obliguar për përgatitjen e akteve dhe materialeve tjera dhe subjektet që bashkëpunojnë në kryerjen e detyrave dhe punëve;
- propozues të akteve dhe materialeve tjera;
- organe shtetërore nga të cilët do të kërkohet pëlqim për aktet, nëse dhënia e pëlqimit është paraparë me ligj;
- afatet në të cilat disa punë duhet të kryhen.

Në programin e punës shënohet cilat dokumente jepen në diskutim publik profesional apo të ndonjë forme tjetër të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve.

Neni 137

Subjektet e obliguara janë të detyruar në afatet e parashikuara që ato akte dhe materiale t'ia paraqesin Këshillit për shqyrtim dhe miratim.

Nëse për shkaqe të caktuara nuk mund të bëhet ajo, ata janë të obliguar që në kohë ta informojnë Këshillin dhe ti paraqesin shkaqet për shkak të të cilave nuk kanë mundur t'i kryejnë detyrat programore në afatin e parashikuar.

VIII. OPINIONI NË PUNËN E KËSHILLIT

Neni 138

Këshilli e informon opinionin për çështjet që shqyrtohen dhe për të cilat vendoset në Këshill, për vendimet dhe qëndrimet e veta për ato çështje, si dhe për punën e komisioneve, me ç'rast zhvillon dhe shfrytëzon forma të ndryshme të informimit.

Neni 139

Përfaqësuesit e mjeteve për informim publik kanë të drejtë të marrin pjesë në Mbledhjet e Këshillit dhe të komisioneve dhe ta njoftojnë opinionin për punën e tyre.

Për mbledhjen e Këshillit në të cilën diskutohet ndonjë çështje pa praninë e opinionit, Këshilli mund ta njoftojnë opinionin përmes lajmërimeve.

Neni 140

Përfaqësuesve të mjeteve për informim publik u jepen në disponim projektet dhe propozimet e dispozitave, materialet informative dhe dokumentuese, raportet për punën e komisioneve të Këshillit dhe procesverbalet nga Mbledhjet e Këshillit, përveç nëse ndonjë çështje shqyrtohet pa praninë e opinionit.

Neni 141

Këshilli mund të vendosë që ndonjë projekt, respektivisht propozim të ndonjë vendimi të caktuar apo akti tjetër të përgjithshëm i cili debatohet në Këshill, të shpallet përmes shtypit ose publikimit të posaçëm.

Neni 142

Këshilli për shkak të informimit të opinionit për punën e vet, mund të vendosë që të jep kumtesë zyrtare për mjetet e informimit publik.

Neni 143

Konferencë për shtyp për çështjet në kompetencë të Këshillit, gjegjësisht lidhur me punën e tij, mban kryetari i Këshillit, me iniciativën e vet ose atëherë kur do të vendosë Këshilli.

Kryetari i Këshillit, gjegjësisht Këshilli, mund të caktojnë anëtar tjetër të Këshillit, i cili do ta mbajë pres-konferencën për shtyp.

IX. AKTET E KËSHILLIT

Neni 144

Këshilli miraton dispozita për rregullimin e çështjeve nga kompetencat e veta dhe përcjellë zbatimin e tyre.

Këshilli miraton Statutin, Rregulloren e Këshillit, buxhetin dhe llogarinë vjetore për realizimin e buxhetit, programe, plane, vendime, aktvendime, rregullore, rekomandime, konkluzione dhe akte tjera.

Dispozitat e kësaj rregulloreje, që kanë të bëjnë me procedurën për marrjen e vendimeve, zbatohen në mënyrë adekuate edhe gjatë procedurës për miratimin e dispozitave dhe akteve tjera nga paragrafi 2 të këtij neni, nëse me ligj dhe me Statut nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 145

Me rekomandim vihet në pah rëndësia e disa çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me gjendjet dhe ecuritë rrjedhëse në sferë të caktuar ose me kryerjen e vendimeve dhe akteve tjera të përgjithshme të Këshillit dhe shprehet mendimi i Këshillit për ato çështje.

Me rekomandim vihen në pah të drejtat dhe obligimet e subjekteve, të cilëve u drejtohen ato dhe masat që duhet t'i ndërmarrin për zgjidhjen e atyre çështjeve.

Rekomandimi nuk ka karakter obligativ dhe ai u drejtohet subjekteve me të cilët kanë të bëjë, me qëllim që ata ta shqyrtojnë, të marrin qëndrim dhe aksionin e tyre ta orientojnë drejt çështjeve me të cilat ka të bëjë rekomandimi dhe për atë ta informojnë Këshillin.

Neni 146

Këshilli, me konkluzion në kuadër të fushëveprimit të vet mund të përcaktojë obligime të Kryetarit të komunës dhe shërbimeve publike të themeluara nga Komuna, lidhur me përgatitjen e vendimeve apo të akteve tjera të përgjithshme ose lidhur me kryerjen e punëve tjera nga fushëveprimi i tyre.

Këshilli, me konkluzion përcakton vlerësime, respektivisht konstatime për gjendjet dhe merr qëndrime dhe pikëpamje lidhur me çështjet të cilat i diskuton.

Neni 147

Aktvendimi është akt konkret dhe përfundimtar me të cilin Këshilli vendosë për punë të veçanta.

Neni 148

Dispozitat dhe aktet tjera të përgjithshme dhe të veçanta, të miratuara në mbledhjen e Këshillit, i nënshkruan kryetari i Këshillit.

Dispozitave origjinale dhe akteve tjera i vihet vula e Komunës.

Dispozitat origjinale dhe aktet e tjera të Këshillit ruhet në arkivin e Komunës.

Për ruajtjen dhe evidencën e dispozitave origjinale dhe akteve tjera të Këshillit, kujdeset administrata komunale.

X. MIRATIMI I VENDIMEVE

1. Ngritja e procedurës

Neni 149

Vendimet nga kompetenca e vetë i miraton Këshilli në propozim të Kryetarit të Komunës ose të ndonjë anëtari të Këshillit.

Propozim për miratimin e vendimit nga kompetenca e Këshillit, mund të parashtrojnë edhe komisionet kompetente të Këshillit.

Neni 150

Këshilli miraton vendime nga kompetenca e vetë dhe në iniciativë parashtruar nga anëtarët e Këshillit, shërbimeve publike, institucioneve dhe ndërmarrjeve, formave të vetëqeverisjes vendore, shoqatave të qytetarëve, qytetarëve dhe subjekteve tjera.

Iniciativa i dorëzohet Kryetarit të Këshillit, i cili ia dorëzon Kryetarit të Komunës për të dhënë mendim lidhur me të.

Nëse Kryetari i Komunës konsideron se nuk ka nevojë për miratimin e vendimit, për këtë do ta njoftojë Kryetarin e Këshillit dhe parashtruesin e iniciativës duke i theksuar shkaqet për të.

Nëse parashtruesi i iniciativës konsideron se shkaqet nuk janë të arsyeshme, ai iniciativën e vet mundet sërish t'ia parashtrojë përmes kryetarit të Këshillit.

Iniciativa e sërishme për miratimin e vendimit diskutohet në mbledhjen e Këshillit, bashkë me mendimin e Kryetarit të Komunës.

Pasi ta shqyrtojë iniciativën e sërishme, Këshilli mundet me konkluzion ta obligojë Kryetarin e Komunës të përgatisë dhe të parashtrojë propozim-vendim.

Për qëndrimin e marrë sipas iniciativës së përsëritur për miratimin e vendimit, Këshilli do ta njoftojë parashtruesin e iniciativës .

2. Propozim-vendim

Neni 151

Kryetari i komunës dhe propozuesit tjerë, propozimet e tyre për rregullimin e çështjeve të caktuara nga kompetenca e Këshillit i parashtrojnë në formë propozim-vendimesh.

Me përjashtim, Vendimi mund të parashtrohet në formë projekti.

Statuti i komunës dhe Buxheti i komunës detyrimisht parashtrohen në formë projekti dhe sillen në dy faza.

Neni 152

Propozimi i vendimit i përmban shkaqet për të cilat duhet të miratohet vendimi, përmbajtjen e vendimit dhe arsyetimin.

Neni 153

Shkaqet për miratimin e vendimit duhet t'i përmbajë:

- bazat juridike në bazë të të cilave mund të rregullohen çështjet adekuate;
- qëllimin që dëshirohet të arrihet me rregullimin e marrëdhënieve në mënyrën e propozuar, si dhe pasojat që do të dalin nga vendimet e propozuara; dhe
- mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e vendimit dhe mënyrën e sigurimit të atyre mjeteve.

Neni 154

Përmbajtja e vendimit që propozohet të miratohet, përgatitet në lloj dispozite të formuluar në mënyrë juridike.

Neni 155

Teksti i vendimit duhet të jetë i arsyetuar.

Arsyetimi posaçërisht i përfshin: bazat juridike për rregullimin e marrëdhënieve që i përmban vendimi; shkaqet për të cilat merret vendimi; vlerësimin e gjendjeve në sferën që duhet të rregullohet me vendim dhe zbatimin e dispozitave ekzistuese në atë sferë; mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e vendimit dhe mënyrën e sigurimit të tyre, vallë zbatimi i vendimit tërheq obligime materiale për qytetarët, subjektet ekonomike e të tjera, si dhe rrethana të tjera me rëndësi për çështjet që rregullohen me vendimin.

Ndaj arsyetimit të vendimit me të cilin bëhen ndryshime dhe plotësime të vendimit ekzistues, i bashkëngjiten edhe dispozitat e vendimit që ndryshohet gjegjësisht plotësohet.

Neni 156

Këshilli në propozim të anëtarëve të Këshillit mund të sjellë konkluzion se, për arsye që me vendimin rregullohet materie e ndërlikuar dhe voluminoz, si dhe në raste të tjera kur do të vlerësojë se ajo është e nevojshme, propozimi i parashtruar të diskutohet dhe të përcaktohet si projekt.

Pas përfundimit të debatit, Këshilli me konkluzion i përcakton qëndrimet dhe vërejtjet ndaj projektit dhe ia drejton propozuesit, që t'i ketë parasysh gjatë përpunimit të propozimit-vendimit.

Me konkluzion Këshilli,mund të caktojë edhe afat, gjatë të cilit propozuesi duhet ta përgatisë dhe t'ia parashtrojë propozim vendimin, Këshillit.

Neni 157

Propozuesi është i obliguar në arsyetimin e propozimit ashtu të përpunuar posaçërisht t'i theksojë shkaqet për mendimet dhe vërejtjet e papranuara për projektin.

Ndaj propozimit parashtrohet edhe dokumentacioni shoqërues për çështje të ndërlikuara dhe voluminoze, posaçërisht të dhënat për mënyrën e sigurimit të mjeteve financiare të nevojshme për zbatimin e vendimit.

3. Diskutimi i vendimit

Neni 158

Diskutimi i vendimit, në mbledhjen e Këshillit sipas rregullës është unik nëse Këshilli nuk vendos të zhvillojë diskutim sipas pjesëve të vendimit gjegjësisht neneve.

Neni 159

Këshilli mund të vendosë të zhvillojë debat të veçantë parimisht për të sqaruar shkaqet dhe nevojën e miratimit të vendimit të propozuar dhe debat për përmbajtjen e vendimit.

Gjatë debatit për propozimin, parimisht mund të jepen mendime, të kërkohen sqarime dhe të inicohen çështje të tjera lidhur me shkaqet e miratimit të vendimit, bazat juridike dhe përshtatshmërinë e zgjidhjeve që janë dhënë në vendim.

Neni160

Propozuesi i vendimit, gjegjësisht përfaqësuesi i tij ka të drejtë që gjatë tërë diskutimit në lidhje me vendimin të jep sqarime, arsyetime dhe t'i paraqet mendimet e veta.

Neni 161

Kryetari i komunës, gjegjësisht përfaqësuesi të cilin ai e ka autorizuar, mund të merr pjesë në tërë procesin e debatit që zhvillohet për vendimin, në mbledhjen e Këshillit edhe kur nuk është propozues i vendimit.

Propozuesi mund ta tërheq propozimin e vendimit në çdo moment, deri në përmbylljen e diskutimit.

4. Amendamente

Neni 162

Amendamente parashtrohen për ndryshim ose plotësim të aktvendimeve që i përmban propozimi i vendimit për të cilin zhvillohet debat në mbledhjen e Këshillit.

Neni 163

Amendamenti parashtrohet me shkrim.

Amendamenti duhet të jetë i arsyetuar.

Nëse amendamenti përmban dispozita me të cilat angazhohen mjete financiare, propozues i amendamentit është i obliguar njëkohësisht të vë në pah edhe mundësitë për sigurimin e atyre mjeteve.

Neni 164

Amendamenti mundet në të drejtë të parashtrohet më së voni 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit në të cilën do të diskutohet propozim- vendimi, kurse parashtrohet përmes kryetarit të Këshillit.

Neni 165

Kryetari i Këshillit menjëherë ua shpërndan amendamentin të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe Kryetarit të Komunës edhe kur ai nuk është propozues i vendimit.

Amendamentin e propozim vendimit, kryetari i Këshillit ia dorëzon edhe komisionit kompetent, që ta lexojë dhe Këshillit t'i dorëzojë raport.

Neni 166

Nëse amendamenti i propozimit-vendimit përmban dispozita me të cilat angazhohen mjetet financiare, Kryetari i Këshillit, amendamentin menjëherë do t'ia dorëzojë edhe komisionit në kompetencat e të cilit bëjnë pjesë çështjet e buxhetit, që ta studiojë ndikimin e amendamentit ndaj mjeteve me të cilat disponon dhe për burimet e mundshme për financimin e zgjidhjeve të propozuara dhe për atë ta njoftojë Këshillin.

Neni 167

Anëtar i Këshillit, me përjashtim, mund të parashtrojë amendament për propozim-vendimin e mbledhjes së Këshillit, gjatë debatit për atë propozim.

Amendamenti parashtrohet me shkrim dhe duhet të jetë I arsyetuar.

Neni 168

Propozuesi i vendimit mund të parashtrojë amendament deri në përfundimin e debatit për propozim-vendimin.

Kryetari i komunës mund të parashtrojë amendamente edhe për propozim-vendime të cilat nuk i ka parashtruar ai, dhe atë, deri në përfundimin e debatit për propozim-vendimin.

Amendamenti i propozuesit të vendimit dhe amendamenti me të cilin ai është pajtuar, konsiderohen për pjesë përbërëse e propozimit të vendimit.

Neni 169

Kur amendamenti parashtrohet gjatë diskutimit të propozim vendimit, kryetari i Këshillit do ta ndërpresë mbledhjen dhe do të jep pushim që të munden parashtruesit ta përgatisin amendamentin, nëse amandamenti parashtrohet në formë të shkruar.

Neni 170

Nëse miratimi i amendamentit do të shkaktonte ndryshime të rëndësishme në tekstin e propozim-vendimit, për amendamentin nuk mund të vendoset në mbledhjen e Këshillit, derisa komisioni kompetent nuk i parashtron Këshillit raport për atë amendament.

Neni 171

Për amendamentin zhvillohet debat i posaçëm në mbledhjen e Këshillit.

Për amendamentin ka të drejtë të deklarohet propozuesi i vendimit dhe informuesi i komisionit i cili ka diskutuar për vendimin.

Kryetari i Komunës ka të drejtë të deklarohet për amendamentin edhe kur ai nuk e ka parashtruar propozimin e vendimit.

Neni 172

Për amendamentin e propozim-vendimit, parashtruar gjatë diskutimit të propozim vendimit, Këshilli mund të vendos që diskutimin ta anulojë dhe ta vazhdojë në njërën nga Mbledhjet e ardhshme ose diskutimin ta ndërpresë, derisa komisioni kompetent dhe komisioni për dispozita nuk e studiojnë amendamentin.

Këshilli do ta anulojë diskutimin për propozimin e vendimit nëse propozuesi i vendimit, Kryetari i komunës ose komisioni kompetent dhe Komisioni për dispozita, kërkojnë që vendosja për amendamentin të shtyhet që të munden amendamentin ta studiojnë dhe të deklarojnë për të.

Neni 173

Për amendamentet vendoset para se të diskutohet për propozimin e vendimit për të cilin dedikohet amendamenti.

Neni 174

Nëse në të njejtin nen nga propozim-vendimi parashtrohen dy ose më shumë amendamente të ndryshme, për amendamentet votohet sipas rendit të paraqitjes së tyre.

Neni 175

Nëse për ndonjë nga amendamentet propozohet shlyerja e ndonjë neni nga propozim-vendimi, së pari votohet për atë amendament dhe nëse ai amendament miratohet, nuk do të votohet për amendamentet tjera të atij neni.

5. Procedura urgjente për miratimin e vendimit

Neni 176

Vendim mund të sillet edhe me procedurë urgjente në mbledhje të rregullt apo të jashtëzakonshme të Këshillit.

Propozimi i vendimit që propozohet të sillet me procedurë urgjente mund të dorëzohet në vet mbledhje.

Me procedurë urgjente mund të sillet vetëm vendim me të cilin rregullohen çështje të tilla për rregullimin e të cilave ekziston nevojë e vërtetë e pa anulueshme dhe nëse anulimi i rregullimit të atyre çështjeve do të kishte pasoja të mëdha.

Neni 177

Këshilli hap debat që për arsyeshmërinë e propozimit të sillet vendim me procedurë urgjente.

Nëse Këshilli e miraton propozimin vendimin që të sillet me procedurë urgjente, qaset ndaj debatit për propozimin e vendimit.

Neni 178

Këshilli mundet para ose gjatë debatit, të kërkojë nga Komisioni kompetent, urgjentisht ta parashtrojë mendimin dhe propozimin e tij për propozimin e vendimit.

Neni 179

Për propozimin e vendimit I cili sillet me procedurë urgjente, çdo anëtar i Këshillit mund të parashtrojë amendament deri në përmbylljen e debatit.

Nëse me miratimin e amendamentit do të shkaktoheshin ndryshime qenësore në tekstin e propozimit të vendimit, gjegjësisht nëse me amendamentin angazhohen mjete financiare, detyrimisht do të kërkohet mendim nga komisioni kompetent për çështje financiare

Komisioni kompetent për çështje financiare janë të obliguar menjëherë ta shqyrtojnë amendamentin dhe Këshillit t'i parashtrojnë raport.

6. Debat publik dhe profesional mbi projekt-dispozitat

Neni 180

Këshilli në mënyrë të pavarur, me propozimin e Kryetarit të Komunës ose kur është paraparë me ligj, do të sjell konkluzion për organizimin e diskutimit publik ose profesional për projektin e vendimeve dhe akteve tjera të përgjithshme, për të cilat vlerësohet se janë me rëndësi të posaçme për qytetarët e komunës.

Neni 181

Kur do të vendoset që projekt-vendimi ose ndonjë akt tjetër të vihet në diskutim publik dhe profesional, Këshilli do të përcaktojë:

- projekti vendimi dhe akti tjetër i përgjithshëm të shpallen që të jenë të kapshme për qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara;
- të sigurohet marrja dhe shqyrtimi i mendimeve dhe propozimeve që janë dhënë gjatë debatit, dhe
- të përpilohet dhe t'i dorëzohet Këshillit raport për rezultatet e diskutimit.

Për realizimin e detyrave nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli mund të formojë trupa të posaçme punuese.

Nëse projekt vendimi dhe ndonjë akt tjetër i përgjithshëm që vihet në debat është parashtruar nga Kryetari i komunës, Këshilli mund të konkludojë që detyrat nga paragrafi 1 të këtij neni t'i kryejë Kryetari i Komunës ose trup punues të cilin do të formojë ai.

Neni 182

Projekt vendimi dhe akt tjetër i përgjithshëm që vihen në diskutim, shpallen në gazetat ditore ose si shpallje e veçantë.

Ndaj projekt vendimit dhe aktit tjetër të përgjithshëm shpallet edhe thirrja drejtuar qytetarëve dhe subjekteve tjera të interesuara, të japin mendimet dhe propozimet e tyre.

Në thirrje theksohet, kujt i drejtohen mendimet dhe propozimet si dhe afati, deri kur ata mund të jepen.

Afati për caktimin e ddiskutimit nuk mund të jetë më pak se 30 ditë.

Neni 183

Raporti për rezultatet e diskutimit, i përfshin mendimet dhe propozimet e paraqitura në debat.

Raporti i dorëzohet propozuesit të vendimit.

Pasi ta pranojë raportin për rezultatet e diskutimit, propozuesi i vendimit do të përpilojë propozim-vendim me ç'rast do t'i ketë parasysh mendimet dhe sugjerimet e paraqitura në mbledhjen e Këshillit për projekt vendimin, mendimet dhe propozimet e paraqitura gjatë diskutimit.

Ndaj propozimit të vendimit drejtuar Këshillit i bashkëngjitet edhe raporti për rezultatet e diskutimit bashkë me qëndrimet e propozuesit të vendimit për mendimet dhe propozimet e dhëna në debat.

Neni 184

Në organizimin dhe zhvillimin e diskutimit publik realizohet bashkëpunim me bashkësitë vendore, gjegjësisht format tjera të vetëqeverisjes vendore, kurse në organizimin dhe zhvillimin e debatit profesional, me organizata dhe bashkësi profesionale gjegjësisht shoqata qytetarësh.

XI. SHQYRTIMI I RAPORTEVE, ANALIZAVE DHE MATERIALEVE TJERA

Neni 185

Shqyrtimi i raporteve, analizave dhe materialeve tjera të Këshillit, mund të bëhet thjesht, duke kaluar në pikën vijuese të rendit të ditës së Këshillit gjegjësisht të komisionit, ose me miratimin e konkluzës.

XII. DHËNIA E PËLQIMEVE TË STATUTEVE, RAPORTEVE DHE LLOGARIVE VJETORE

Neni 186

Këshilli vendos me aktvendim për dhënien e pëlqimit ose për refuzimin e kërkesës për dhënien e pëlqimit Statutit të shërbimit publik, institucionit dhe ndërmarrjeve të themeluara nga Komuna, si dhe subjekteve tjera për të cilat me ligj është përcaktuar që Këshilli të jep pëlqim.

Nëse Këshilli nuk jep pëlqim, do ta obligojë Kryetarin e Komunës dhe subjektin i cili kërkon pëlqim për statutin të bëjnë harmonizimin e statutit lidhur me çështjet që kanë qenë shkak që të mos jepet pëlqimi I kërkuar.

Neni 187

Statutet detyrimisht i dorëzohen Kryetarit të komunës për shkak të dhënies së mendimit për to, në afat prej 30 ditëve, nga dita e pranimit.

Neni 188

Në mbledhjen e Këshillit në të cilën diskutohet për dhënien e pëlqimit të statutit të shërbimit publik, institucionit dhe ndërmarrjeve themeluar nga Komuna, si dhe subjekteve tjera për të cilët me ligj është përcaktuar Këshilli të jep pëlqim thirret edhe përfaqësues i parashtruesit të statutit.

Neni 189

Statutit të cilit i është dhënë pëlqim zbatohet nga dita e miratimit nga organi kompetent i shërbimit publik, institucionit dhe ndërmarrjeve ta themeluara nga Komuna, si dhe subjekteve tjera për të cilët me ligj është përcaktuar që Këshilli të jep pëlqim.

XIII. RAPORTET E KËSHILLIT ME KRYETARIN E KOMUNËS

Neni 190

Kryetari i Komunës ka të drejtë dhe obligim të jetë i pranishëm dhe të merr pjesë në punën e mbledhjes së Këshillit.

Neni 191

Kryetari i Komunës mund të përcaktojë përfaqësuesin e tij për Mbledhjet e Këshillit dhe të komisioneve.

Përfaqësuesi i Kryetarit të Komunës merr pjesë në Mbledhjet e Këshillit dhe të komisioneve dhe jep informacione dhe sqarime për propozimin e aktit dhe çështjeve tjera që janë në rendin e ditës së mbledhjes.

Neni 192

Kryetari i Këshillit dhe kryetarët e komisioneve detyrimisht e informojnë Kryetarin e Komunës për Mbledhjet e caktuara.

XIV. RAPORTET E KËSHILLIT ME SHËRBIMET PUBLIKE, INSTITUCIONET DHE NDËRMARRJET

Neni 193

Këshilli mund të kërkojë nga Kryetari i Komunës ose nga organet e udhëheqjes së shërbimeve publike që i ka themeluar Komuna, raport për gjendjet në sferë të caktuar, për zbatimin e politikës dhe realizimin e dispozitave dhe akteve tjera të përgjithshme që i ka sjellur Këshilli në kuadër të kompetencave të veta, si dhe për detyra tjera për të cilat janë të autorizuar nga ana e Këshillit.

Këshilli mundet, me konkluzion, të caktojë afat gjatë të cilit shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet e themeluara nga Komuna, janë të obliguara të parashtrojnë raport.

Shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet e themeluara nga Komuna munden edhe me vet-iniciativë ta njoftojnë Këshillin për gjendjen në sferën përkatëse, për zbatimin e politikës dhe për realizimin e dispozitave dhe akteve tjera të përgjithshme që i ka sjellur Këshilli, si dhe për çështje të tjera nga fushëveprimi i tij.

Neni 194

Këshilli dhe komisionet e tij në kuadër të fushëveprimit të vet mund të kërkojnë që, shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet:

- të studiojnë çështje të caktuar nga fushëveprimi i tyre dhe për atë t'u parashtrojnë raport;
- t'i njoftojnë për gjendjen dhe dukuritë nga sfera e fushëveprimit të tyre;
- t'i njoftojnë për zbatimin e politikës që e ka përcaktuar Këshilli dhe për realizimin e vendimeve, rregullave dhe akteve tjera të përgjithshme dhe për disa çështje nga sfera e fushëveprimit të vet;
- të përgatisin propozim-vendim të ndonjë dispozite apo akti tjetër të përgjithshëm nga sfera e fushëveprimit të tyre; dhe
- t'i dorëzojnë të dhënat me të cilat posedojnë apo të cilat janë të obliguar që në kuadër të fushëveprimit të vet t'i grumbullojnë dhe evidentojnë si dhe shkresat dhe materialet tjera të nevojshme për punën e Këshillit dhe trupat e tij punues.

Nëse subjekti nga paragrafi 1 të këtij neni konsideron se nuk mund të veprojë sipas kërkesës së Këshillit dhe komisionit të tij, do t'i njoftojë për atë Këshillin, komisionin dhe Kryetarin e Komunës, me ç'rast do ti paraqet edhe shkaqet për të cilat nuk mund ta bëjë atë.

Neni 195

Këshilli dhe komisionet i njoftojnë shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet për Mbledhjet në të cilat do të diskutohen çështje që kanë të bëjnë me sferën e fushëveprimit të tyre, në mënyrë që në to të marrin pjesë përfaqësuesit e tyre.

Neni 196

Personat udhëheqës kanë të drejtë dhe obligim të marrin pjesë në punën e mbledhjeve të Këshillit, kur në ato Mbledhja diskutohet propozim i aktit me të cilin rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet, me të cilat ata udhëheqin ose çështje tjetër që kanë të bëjë me sferën e fushëveprimit të tyre.

Në mbledhjen e Këshillit, personat udhëheqës japin informacione dhe sqarime për çështjet që shqyrtohen, kurse janë të obliguar, me kërkesë, të japin edhe informata dhe sqarime të tilla edhe me shkrim.

Neni 197

Personat udhëheqës janë të obliguar në kërkesë të komisioneve të Këshillit, të marrin pjesë në punën e mbledhjeve të tyre, kur shqyrtohet propozim akti me të cilin rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me fushëveprimin e shërbimeve publike, institucioneve dhe ndërmarrjeve, me të cilat udhëheqin ata.

Neni 198

Nëse personi udhëheqës nuk mund të merr pjesë në punën e mbledhjes së Këshillit apo të trupit punues, mund të caktojë një përfaqësues të tij i cili do të merr pjesë në punën e mbledhjes.

XV. RAPORTET E KËSHILLIT ME KËSHILLAT E KOMUNAVE

Neni 199

Raportet e ndërsjella të Këshillit me këshillat e komunave tjera realizohen në suazat e përcaktuara me ligj, Statutin e komunës dhe me këtë Rregullore.

Këshilli bashkëpunon me këshillat e komunave tjera dhe zhvillon me to raporte të ndërsjella në realizimin e detyrave me interes të përbashkët posaçërisht në aspekt të krijimit të kushteve sa më të volitshme për realizimin e të drejtave të qytetarëve.

Neni 200

Këshilli mund të bashkëpunojë me këshillat e komunave në procedurën për përgatitjen e dispozitave dhe akteve tjera me interes të përbashkët, për harmonizimin e qëndrimeve dhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta organizative dhe të tjera për kryerjen e kompetencave të komunave.

Neni 201

Bashkëpunimi i Këshillit të Komunës me këshillat e komunave tjera bazohet mbi parimet e barazisë dhe koordinimit në të gjitha fazat e përgatitjes dhe zbatimit të dispozitave dhe akteve tjera me interes të përbashkët.

Neni 202

Bashkëpunimi i Këshillit me këshillat e komunave tjera, mund të bëhet përmes këmbimit të informatave, dokumentacionit dhe materialeve tjera, me formimin e grupit të përbashkët punues për studimin e çështjeve të caktuara me interes për komunat, si dhe përmes llojeve tjera të bashkëpunimit të ndërsjellë.

XVI. KRYERJA E PUNËVE PROFESIONALE TË KËSHILLIT

Neni 203

Punët profesionale dhe ato të tjera për nevojat e Këshillit, të komisioneve të tij dhe për anëtarët e Këshillit i kryen administrata komunale.

Administrata komunale:

- merr pjesë në përgatitjen e programit të punës të Këshillit,
- merr pjesë në përgatitjen e mbledhjeve të Këshillit dhe të trupave punues,
- merr pjesë në përgatitjen e vendimeve dhe akteve tjera të përgjithshme dhe materialeve tjera,
- jep ndihmë profesionale anëtarëve të Këshillit,
- kryen punë informative – dokumentuese për nevojat e Këshillit,
- siguron kushte të domosdoshme për punën e anëtarëve të Këshillit, dhe
- kryen punë administrative-teknike dhe punë të tjera për nevojat e Këshillit dhe komisioneve.

XVII. NDRYSHIMI I RREGULLORES

Neni 204

Iniciativë për ndryshimin e Rregullores mund të parashtrojnë anëtarët e Këshillit, komisionet dhe Kryetari i komunës.

Për iniciativën për ndryshimin e Rregullores vendos Këshilli.

Neni 205

Pas pranimit të iniciativës për ndryshimin e Rregullores,Këshilli formon Komision për Rregullore e cila përgatit projekt për ndryshimin e Rregullores.

Projekt Vendimi për ndryshimin e Rregullores e përcakton Këshilli dhe me Konkluzion e obligon Komisionin për rregullore të përgatit propozim vendim për ndryshimin e Rregullores, me çka do ti ketë parasysh mendimet dhe vërejtjet e propozuara në debat para Këshillit dhe trupat punues të tij.

XVIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 206

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje përfundon të vlejë Rregullorja e Këshillit të Komunës së Jegunovcit nr. 08-127/3 të datës 30.06.1997.

Neni 207

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Informatorin zyrtar të komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-396/3
27.02.2026
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska,d.v.